

Vendim nr. 92 datë 03.05.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 03.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (R) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: REMZI KASA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 894, datë 21.04.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-3482 (515), datë 20.09.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “t”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka mbetur i plagosur rëndë si pasojë e një aksidenti automobilistik të ndodhur në datën 27.10.2011 në segmentin Fushë Krujë – Vorë. Në lidhje me këtë ngjarje është shpallur fajtor me vendim të formës së prerë drejtuesi i automjetit. Ndërkohë, ka rezultuar se automjeti shkaktues i dëmit ka qenë i siguruar pranë një shoqërie sigurimesh. Kërkuesi dhe fëmijët e tij i janë drejtuar gjykatës me padi për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror (biologjik, ekzistencial dhe moral), të shkaktuar nga ngjarja aksidentale, duke thirrur në gjykim si palë të paditur shoqërinë e sigurimit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3281, datë 10.03.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadsisë dhe detyrimin e shoqërisë së sigurimit që t'u paguajë paditësve shumën 2.021.822 lekë, si shpërblim për dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe interesat në shumën 124.139 lekë, plus interesat deri në ekzekutimin e vendimit. Përlllogaritja e dëmit është bërë nga ajo gjykatë bazuar në parashikimet e vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 12, datë 14.09.2007 (*vendimi unifikues nr. 12/2007*). Ajo gjykatë ka arsyetuar se ngjarja e sigurimit ka ndodhur në datën 27.10.2011 dhe për llogaritjen e dëmit, referuar kohës kur ka ndodhur ajo, nuk mund të zbatohet rregullorja nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", e ndryshuar (*rregullorja nr. 53/2009*), e miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), pasi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 180, dhjetor 2011, për rrjedhojë nuk ka qenë në fuqi në kohën e ngjarjes. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala paditëse dhe pala e paditur.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 894, datë 21.04.2015, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur detyrimin e shoqërisë së sigurimit që t'u paguajë paditësve shumën 671.865 lekë, si dëmshpërblim për dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe interesat për këtë shumë në vlerën 41.252 lekë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se vendimi unifikues nr. 12/2007 është zbatuar në kushtet e mungesës së akteve ligjore dhe nënligjore specifike dhe se ky boshllëk tashmë nuk ekziston më, pasi është miratuar ligji nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar (*ligji nr. 10076/2009*). Sipas asaj gjykate, në kohën kur ka ndodhur ngjarja, ka qenë në fuqi edhe rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së dhe referuar nenit 51 të saj, vetë rregullorja ka parashikuar shprehimisht fuqinë prapavepruese të efekteve të saj. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka arsyetuar se vlera e dëmit duhet të llogaritet duke marrë për bazë ligjin nr. 10076/2009 dhe rregulloren nr. 53/2009 të AMF-së. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs paditësit.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3482 (515), datë 20.09.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi është e zbatueshme rregullorja nr. 53/2009, e cila ka qenë në fuqi në kohën e regjistrimit të padisë në gjykatë (datë 26.11.2012), pasi ka qenë e botuar në Fletoren Zyrtare në atë kohë (botuar në datën 31.12.2011).

5. Në datën 19.03.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 02.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuetit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar:

6.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspekt të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë dhe gjykata e apelit kanë dhënë vendime të mbështetura në dispozitat e një akti që nuk ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur ngjarja, duke i dhënë në këtë mënyrë fuqi prapavepruese aktit. Gjithashtu, gjykata e apelit ka mbajtur qëndrime të ndryshme për çështje të së njëjtës natyrë.

6.2. *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuetit*

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e

kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4-muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se si datë e fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, që i korrespondon momentit të konstatimit të cenimit, është data e marrjes dijani efektivisht për vendimin gjyqësor të marrë në ushtrim të mjetit të fundit ankimor. Në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijani konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, referuar informacionit të marrë nga Gjykata e Lartë në datën 22.04.2024, Kolegji konstaton se vendimi i kundërshtuar, i marrë në dhomën e këshillimit, është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, duke u bërë i disponueshëm për palët në datën 17.11.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 19.03.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

12. Një tjetër kriter paraprak është legjitimiteti *ratione materiae*. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e *parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme*, së pari, pasi gjykatat për zgjidhjen e çështjes së tij i janë referuar një akti që nuk ka qenë në fuqi në kohën e ngjarjes. Sipas tij, në bazë të nenit 117 të Kushtetutës, rregullorja nr. 53/2009 e

AMF-së i fillon efektet pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe jo pas publikimit në faqen zyrtare të AMF-së. Për pasojë, llogaritja e masës së dëmshpërblimit në rastin konkret duhet të ishte bërë në bazë të ligjit nr. 10076/2009, që ka qenë akti në fuqi në momentin e ngjarjes. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar në mënyrë të gabuar momentin e lindjes së të drejtave lidhur me këtë mosmarrëveshje juridiko-civile, duke e lidhur me datën kur paditësi ka kërkuar në gjykatë zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe jo me momentin e ndodhjes së ngjarjes. Duke referuar në norma që nuk kanë qenë ende në fuqi, ato gjykata kanë cenuar pritshmëritë e ligjshme të kërkuarit lidhur me masën e dëmshpërblimit si pasojë e aksidentit automobilistik, duke përkeqësuar për pasojë pozitën e tij. Së dyti, Kolegji vëren se kërkuari pretendon se është cenuar parimi i sigurisë juridike edhe lidhur me vendimmarrje të ndryshme për çështje të së njëjtës natyrë nga ana e gjykatës së apelit, duke krijuar kështu standarde të ndryshme të interpretimit të ligjit.

13. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë për një proces të rregullt ligjor, në të cilin përfshihet parimi i sigurisë juridike. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e këtij parimi, i cili nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 50, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt”, përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 10, datë 13.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nga ana tjetër, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se një çështje nuk hyn në sferën e kompetencës së Gjykatës nëse paraqet probleme të veprimit të ligjit në kohë ose kërkon vlerësime lidhur me vendosjen respektive hierarkike të normave në konflikt, të cilat, si të tilla, hyjnë në sferën e kompetencës të gjykatave të zakonshme. Në këtë pikëpamje, dyshimet në lidhje me veprimin në kohë të normave juridike duhet të zgjidhen nga gjykatat e zakonshme bazuar në parashikimet kushtetuese që përcaktojnë momentin e hyrjes në fuqi të tyre (neni 117 i Kushtetutës), si edhe bazuar në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve ligjore (nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës), nga të cilat burojnë edhe parimet ku bazohen gjykatat për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rast të përplasjeve mes normave me fuqi të njëjtë ose të ndryshme juridike (*shih vendimin nr. 94, datë 14.07.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

15. Gjykata ka theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të së drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit (*shih vendimet nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në funksion të parimit të subsidiaritetit të gjykimit kushtetues dhe kompetencës së Gjykatës së Lartë, jo vetëm për kuptimin dhe zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, por edhe për kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese, i takon asaj gjykate të vlerësojë vendimet e gjykatave të zakonshme edhe në drejtim të uniformitetit të interpretimit e zbatimit të së drejtës, si element i parimit të sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Duke vlerësuar respektimin e këtyre standardeve në çështjen konkrete, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit, në thelb, lidhen me identifikimin e kuadrit ligjor të zbatueshëm në çështjen e tij, duke vlerësuar momentin e lindjes së mosmarrëveshjes juridiko-civile në raport me momentin e hyrjes në fuqi të aktit normativ dhe efektet juridike të këtij të fundit. Në lidhje me këtë, kërkuari ka pretenduar edhe se gjykata e apelit ka krijuar standarde të ndryshme të interpretimit të ligjit për çështje të së njëjtës natyrë. Referuar këtij pretendimi, Kolegji evidenton se vendimi gjyqësor bazohet, në çdo rast, në vlerësimin e rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim dhe provave të administruara në atë gjykim. Për rrjedhojë, fakti që në rastin e kërkuarit gjykata e apelit ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga çështje të tjera në dukje të ngjashme, nuk përbën *apriori* cenim të parimit të sigurisë juridike. Gjithashtu, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit në tërësi, për nga mënyra se si janë ngritur, kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, që, si rregull, është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe për pasojë nuk përbëjnë lëndë kushtetuese.

17. Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për pronë private, por ai nuk ka parashtruar asnjë argument në favor të këtij pretendimi, duke mos e ngritur atë në nivel kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se as ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim, pasi nuk është argumentuar nga pikëpamja kushtetuese.

18. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk përmbush kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.